



AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës,
trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues

Tel/Fax: +355 4 2380 300/320
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. K4/I82-2 Prot.
Nr. Dok. 202503636/2

Tiranë 3/11/2025

Lënda: Rekomandime për inspektimin e bërë në Komisaratin e Policisë Krujë
dhe Stacionin e Policisë Fushë- Krujë

Drejtuar: Z. Ilir PRODA
Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit

TIRANË

Z. Elton ALUSHI
Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë

TIRANË

Z. Luan SINANAJ
Komisariatit të Policisë Krujë

KRUJË

Të nderuar,

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin e deritanishëm dhe duke vlerësuar angazhimin dhe punën e të gjithë stafit të institucionit që ju drejtoni, si dhe frymën e mirë të bashkëpunimit dhe mirëkuptimit midis institucioneve tona, në vijim po ju njohim mbi gjetjet e inspektimit që institucioni i Avokatit të Popullit kreu në Komisaratin e Policisë Krujë dhe në Stacionin e Policisë Fushë-Krujë më datë 10.10.2025.

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues, në vijim Mekanizmi Kombëtar (MKPT), seksion pranë Avokatit të Popullit, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, kreu një inspektim në ambientet e shoqërimit të Komisarariatit të Policisë Krujë dhe Stacionit të Policisë Fushë-Krujë.

Inspektimi u krye sipas një Plani Vjetor Inspektimi të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit inspektues ishin znj. Gloria Çarkaxhiu dhe znj. Nertila Qafzezi me detyrë Nd/Komisionerë pranë Mekanizmit Kombëtar.

Inspektimi kishte si qëllim verifikimin e respektimit të standardeve të përcaktuara në ligjin nr. 82/2024 “Për Policinë e Shtetit”, Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 1720, datë 20.11. 2023 për miratimin e procedurës standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre” dhe Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 894, datë 19.07. 2022, për miratimin e procedurës standarde “Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”. Inspektimi ishte i paparalajmëruar.

Institucioni i Avokatit të Popullit, pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues dhe nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga inspektimi i vitit të kaluar¹, ka detyrimin ligjor t’ju parashtrojë konkluzionet përfundimtare, që do të gjeni më poshtë:

Shënime të përgjithshme

Bazuar në metodologjinë e inspektimit në institucionet ku mbahen dhe trajtohen shtetasit e privuar nga liria, vizitat monitoruese të MKPT-së janë të pa paralajmëruara. Grupi i inspektimit u takua fillimisht me shefin e Komisariatit z. Luan Sinanaj i cili u vu në dijeni në lidhje me qëllimin e inspektimit.

Shefi i Komisariatit, informoi grupin e inspektimit se ka filluar dhe është në zbatim projekti “Rikonstruksion/Ndërtim i objekteve të Komisariatit të Policisë Krujë”.

Projekti me emërtimin “Ndërtim/Rikonstruksion i objekteve të Komisariatit të Policisë Krujë” i ka nisur punimet në datën 02.10.2024 dhe është parashikuar të përfundojë brenda vitit 2025. Vlera e kontratës është 204,079,296.16 lekë me TVSH dhe janë realizuar rreth 77% e totalit të punimeve.

Përgjatë inspektimit u informuam se trajtimi dhe sigurimi i personave të shoqëruar në juridiksionin e Komisariatit të Policisë Krujë kryhej në ambientet e shoqërimit të Stacionit të Policisë Fushë-Krujë.

Nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit në inspektimin e mëparshëm, rezultoi se:

- **Ishin marrë masat** për fillimin e punimeve për rikonstruksionin e objekteve ekzistuese dhe ndërtimit të objektit të ri të Komisariatit të Policisë Krujë për të garantuar tërësisht kërkesat e ligjit nr. 82/2024 “Për Policinë e Shtetit”, si dhe procedurës standarde të miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të

¹ Rekomandim nr. K4/I49-2 Prot, dt.15.10.2024 “Rekomandim për inspektimin e bërë në ambientin e shoqërimit në Komisariatit të Policisë Krujë.”

Policisë së Shtetit nr. 894, datë 19.07.2022, “*Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë*”.

- **Ishin marrë masat** nga Stacioni i Policisë së Fushë-Krujës për plotësimin me saktësi të regjistrimit të të miturve në konflikt me ligjin, si dhe evidentimin në çdo rast të të gjithë personave të pranishëm gjatë intervistimit të të miturve.

Ndërkohë, grupi inspektimit konstatoi se:

- **Nuk ishin marrë masat** për krijimin në ambientin e shoqërimit në Stacionin e Policisë Fushë-Krujë të një dhome për marrjen në pyetje të të shoqëruarve (të arrestuar në flagrancë), para se të kalojnë në dhomat e sigurisë, si dhe instalimin e sistemit të monitorimit me video dhe audio në dhomën e marrjes në pyetje/intervistimin e personave të shoqëruar nga oficerët e policisë gjyqësore, për personat që do të akomodohen në ambientet e sigurisë të Bllokut të Sigurisë në Tiranë².
- **Nuk ishin marrë masat** për krijimin e një ambienti të posaçëm për intervistimin e të miturve në konflikt me ligjin, duke ofruar një ambient të përshtatshëm, që duhet të jetë i rregulluar në mënyrë të posaçme për zhvillimin e bisedave me fëmijët.
- **Nuk ishin marrë masat** nga Stacioni i Policisë Fushë- Krujë, për sigurimin e sistemit të ngrohjes ose vendosjen e pajisjeve elektrike në dhomat e shoqërimit, për ngrohjen e këtyre ambienteve kryesisht në periudhën e dimrit.

Ambientet e shoqërimit dhe kushtet e tyre në Stacionin e Policisë Fushë- Krujë.

Në Stacionin e Policisë Fushë-Krujë ambientet e shoqërimit ishin realizuar pjesërisht sipas parashikimeve të bëra në ligjin nr. 82/2024, “*Për Policinë e Shtetit*”, dhe procedurës standarde dhe Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 894, datë 19.07.2022, për miratimin e procedurës standarde “*Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë*”, ku parashikohet se dhomat e shoqërimit duhet të jenë me sipërfaqe dhe hapësira të bollshme për qëndrim, si dhe të ndara më vete për gratë, meshkujt madhorë dhe të miturit.

Mjediset e shoqërimit ndodheshin në katin e parë të një godine dy katëshe brenda stacionit të policisë, dhe kishte 3 (tre) dhoma shoqërimi, të cilat ndaheshin në një

² Kreu VI, pika 4 gërma “i” e procedurës standarde ku thuhet se: “i. Pranë dhomave të shoqërimit dhe pjesë të këtij sistemi projektohen dhe ndërtohen ambiente të posaçme: i.1 Dhomë për intervistimin/marrjen në pyetje të personave të shoqëruar para se të akomodohen/futen në dhomat e sigurisë të DVP/komisariatit të policisë (personat që do të arrestohen/ndalohen)”.

dhomë shoqërimi për meshkujt madhorë, një (1) dhomë shoqërimi për gra dhe një (1) për të mitur.

Dhomat e shoqërimit në Stacionin e Policisë Fushë-Krujë, janë rikonstruktuar në vitin 2022, ato ishin me sipërfaqe dhe hapësirë të bollshme për qëndrimin dhe trajtimin e të shoqëruarve. Secila nga dhomat ishte e pajisur me nga dy stola të fiksuar në dysHEME, si dhe të pajisura me tavolina për qëndrimin e të shoqëruarve në këto ambiente.

Dritaret e dhomave të shoqërimit ishin me përmasa të tilla që lejonin mundësinë për ajrim dhe ndriçim të plotë natyral, si dhe kishin ndriçim nga rrjeti elektrik. Dhomat ishin të pastra nga ana higjieno-sanitare, si dhe ishin të lyera. Në pjesën e jashtme, dritaret ishin të siguruara me rrjetë të hollë teli, për arsye të sigurisë së personave që ndodhen në këto ambiente. Nga inspektimi konstatuam se dyert e dhomave të shoqërimit nuk i plotësonin standardet e parashikuara.

Në Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 894, datë 19.07.2022, për miratimin e procedurës standarde *“Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”*, në pikën 4. *“Kushtet e mbajtjes dhe Siguria për personat e shoqëruar”* përcaktohet se: e.6 Normat dhe standardet që duhet të plotësojnë dyert e dhomave të ambienteve të shoqërimit janë:

e.6.1 Përmasat e dyerve janë jo më pak se 1.0 x 2.0 m, prej materiali druri masiv të fortë dhe të staxhionuara (jo prej materiali fibër, kartonë apo tamburatë).

e.6.2 Dyert e dhomave të shoqërimit për të rriturit nga ana e brendshme përforcohen me një fletë llamarinë e cila montohet dhe puthitet me sipërfaqen e drurit të derës duke eliminuar/fshehur tehet prerës të saj.

Në Stacionin e Policisë Fushë-Krujë në dhomat e shoqërimit nuk kishte sistem ngrohje/ftohje.

Në korridorin ku ndodheshin dhomat e shoqërimit, kishte 2 tualete për personat e shoqëruar të ndarë për burra dhe gra³. Tualetet ishin të pajisur me nyje hidrosanitare dhe furnizoheshin me ujë të rrjedhshëm e të ngrohtë pa ndërprerje.

Në ambientin dhe dhomat e shoqërimit të stacionit të policisë, ishin të instaluar kamera për mbajtjen në vëzhgim të korridorit dhe të dhomave në mjedisin e

³ Pika 4 e procedurës standarde *“Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”*. e.2 Pranë dhomave të shoqërimit dhe ngjitur me to ndërtohen dhe funksionojnë tualetet për kryerje të nevojave personale të ndara për femra dhe meshkuj, me sipërfaqe të mjaftueshme për vendosjen e pajisjeve përkatëse dhe funksionimin për qëllimin që kanë, me sipërfaqe 6 – 8 m².

shoqërimit, të cilat monitoroheshin nga punonjësit e policisë, nëpërmjet kompjuterit i cili ndodhej në zyrën e informacionit.

Në Stacionin e Policisë Fushë-Krujë, oficerët e policisë gjyqësore i kryenin veprimet procedurale me shtetasit në zyrat e tyre. Këto zyra nuk ishin të monitoruara dhe ndërkohë në këtë stacion nuk kishte ambiente të veçanta intervistimi të monitoruara me kamera për këqyrjen e veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore.

Nga monitorimi që u bë zyrave të oficerëve të policisë gjyqësore, nuk u gjetën sende prania e të cilave të ekspozonte dhunë tek personat me të cilët ata kryenin veprime procedurale. Në këtë stacion policie kishte një dhomë magazinë për administrimin dhe ruajtjen e provave materiale.

Në Procedurën Standarde të Punës “Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”, me Urdhrin nr. 894, datë 19.07. 2022, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit përcaktohet qartë se: *Pranë dhomave të shoqërimit dhe pjesë të këtij sistemi projektohen dhe ndërtohen ambiente të posaçme si: i.1 Dhomë për intervistimin/marrjen në pyetje të personave të shoqëruar* para se të akomodohen/futen në dhomat e sigurisë të DVP/komisariatit të policisë (personat që do të arrestohen/ndalohen).

“i.1.1 Ky ambient përveç kushteve të përcaktuara për dhomat e shoqërimit duhet të plotësojë dhe këto kushte:

Të ketë të instaluar tavolinë pune dhe karrige për oficerin e policisë gjyqësore dhe pajisje elektronike për dokumentimin e veprimeve procedurale që kryhen nga OPGJ (kompjuter, printer, letër, etj).

Tavolinë pune dhe dy karrige për qëndrimin e avokatit mbrojtës dhe të personit të dyshuar/akuzuar i cili do të intervistohet, arrestohet/ndalohet, etj.

Instalohen sisteme dhe pajisje për regjistrimin elektronik audio dhe video të të gjitha veprimeve procedurale që kryhen me personin e shoqëruar nga oficerët e policisë gjyqësore, para se personi të akomodohet në dhomat e sigurisë të DVP/komisariatit të policisë si i arrestuar/ndaluar.”⁴

Në Stacionin e Policisë Fushë-Krujë për periudhën janar-tetor 2025 në regjistrin për evidentimin e personave të shoqëruar ishin evidentuar të dhënat për 283 persona, ndër të cilët 261 shtetas burra, 5 shtetase gra dhe 17 shtetas të mitur. Në kohën përgjatë

⁴ Urdhri i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 894, datë 19.07.2022, për miratimin e procedurës standarde “Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”

inspektimit, në mjedisin e shoqërimit nuk ndodhej asnjë person në cilësinë e të shoqëruarit.

Në ambientin e shoqërimit ishin vendosur postera me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar. Në posterat përkatës dhe në gjuhë të huaj ishte pasqyruar edhe e drejta ligjore e personave të shoqëruar për të paraqitur ankesa, gjithashtu ato ishin të vendosura edhe brenda dhomave të shoqërimit.

Gjithashtu konstatuam se në këtë stacion policie zbatohej praktika për pajisjen e personit të shoqëruar me kartën e të drejtave të personave të shoqëruar, që në momentin e parë të shoqërimit, kartat e të drejtave ishin të printuara dhe qëndronin tek zyra e oficerit të shërbimit.

Ambientet e sigurisë dhe kushtet e tyre

Në Stacionin e Policisë Fushë-Krujë nuk kishte ambiente të sigurisë dhe personat e arrestuar/ndaluar dërgoheshin në dhomat e sigurisë në Bllokun e Sigurisë Tiranë.

Regjistri për evidentimin e personave të shoqëruar, si dhe trajtimi i të shoqëruarve, gjatë veprimeve që kryen policia

Gjatë inspektimit u konstatua se në Stacionin e Policisë Fushë-Krujë, “Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar” ishte i tipit “Model nr. 1” konform Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 894, datë 19.07.2022, për miratimin e procedurës standarde “Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”.

Të gjithë personat e shoqëruar në stacionin e policisë sipas dispozitave të ligjit nr. 82/2024 “Për Policinë e Shtetit”, regjistroheshin në këtë regjistër nga punonjësit e zyrës së informacionit. Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se: Koha e qëndrimit në gjendje shoqërimi të shtetasve ishte e ndryshme nga 1 deri në 5 orë në raste të veçanta. Rubrikat e regjistrit ishin plotësuar me saktësi nga punonjësit e policisë të këtij institucioni.

Në zyrën e informacionit të Stacionit të Policisë Fushë-Krujë kishte një regjistër më vete për evidentimin e të dhënave të personave të mitur të shoqëruar, bazuar në rekomandimin e Avokatit të Popullit për këtë qëllim⁵. Nga këqyrja e këtij regjistri u evidentua se ishte kryer evidentimi dhe plotësimi i regjistrit me të gjithë personat e

⁵ Rekomandim nr.437 prot., datë 11.10.2019 “Për garantimin e të drejtave të të miturve të privuar nga liria në zbatim të legjislacionit të ri të administrimit të drejtësisë penale për të mitur”.

pranishëm gjatë intervistimit të të miturit në rubrikën “*Persona të pranishëm gjatë intervistimit (prindi, mbrojtësi ligjor, psikolog, përfaqësuesi ligjor)*”.⁶

Në Stacionin e Policisë Fushë-Krujë kishte regjistër për evidentimin e kërkesë/ankesave, por për vitin 2025 nuk ishte evidentuar asnjë kërkesë apo ankesë nga shtetasit e shoqëruar. Regjistrat ishin të sekretuar.

Avokati i Popullit thekson se plotësimi i regjistrave në kohë dhe me korrektësi është një standard thelbësor me funksion parandalues për të garantuar të drejtat e njeriut.

Mjediset e intervistimit

Në Stacionin e Policisë Fushë-Krujë, nuk ka një dhomë më vete të monitoruar me sistemin e kamerave, që të shërbejë për intervistimin/ marrjen në pyetje të personave të shoqëruar nga punonjësit e policisë. Në raportin drejtuar Qeverisë Shqiptare mbi vizitën e Komitetit për Parandalimin e Torturës (KPT) në Shqipëri të kryer në datat 4-15 maj 2023 është evidentuar qartë nevoja e krijimit të dhomave të intervistimit⁷: Në fakt, një strukturë e tillë mund të sigurojë një regjistrim të plotë dhe autentik të procesit të intervistimit, duke lehtësuar në masë të madhe hetimin e çdo pretendimi për keqtrajtim. Ky fakt është në interes si të personave që janë keqtrajtuar nga policia, ashtu edhe të punonjësve të policisë që janë përballur me pretendime të pabaza se janë përfshirë në keqtrajtime fizike apo presione psikologjike.

Në parim, regjistrimi audio-vizual duhet të mbulojë të gjitha fazat e marrjes në pyetje nga policia, duke përfshirë dhënien e informacionit për të drejtat në fillim të intervistës. Kjo do të sigurojë që marrja në pyetje nga ana e policisë të kryhet në përputhje me ligjin dhe do të ndihmojë në parandalimin e çdo praktike të nënshtrimit të personave të ndaluar në marrje në pyetje joformale përpara marrjes në pyetje zyrtare. KPT inkurajon autoritetet shqiptare të zgjerojnë aplikimin e regjistrimit audio-vizual të intervistave të policisë për marrjen në pyetje të të gjithë personave të ndaluar.

Avokati i Popullit e konsideron procesin e intervistimit të personave të shoqëruar në një ambient më vete, që të jetë i monitoruar nëpërmjet sistemit të kamerave të sigurisë, si një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi monitorimi filmik ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e vetë punonjësit të policisë së shtetit, ashtu dhe nga të shoqëruarit, ndaluarit e arrestuarit.

⁶ Urdhri nr. Nr. 756, datë 10.08. 08.2021 “Për miratimin dhe vënien në funksionim të Regjistratit të Evidentimit të të Dhënave për Personat e Shoqëruar të Mitur (14 – 18 vjeç), në ambientet e Policisë së Shtetit”, të D.P.P Sh.”

⁷ electronic recording of police interviews, fq,13, <https://rm.coe.int/1680ae233b>.

Gjithashtu, edhe intervistimi apo marrja në pyetje e të miturve në konflikt me ligjin që shoqërohen, kryhej në zyrat e punës të punonjësve të policisë dhe jo në ambiente të veçanta, sikurse është e parashikuar në dispozitat e Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur dhe procedurën standarde⁸. Mekanizmi Kombëtar e konsideron me rëndësi të veçantë faktin se, intervistat me të miturit duhet të realizohen në një ambient të përshtatshëm dhe të pajisur me orënditë e nevojshme si tavolina dhe karrige, në një mjedis sa më të qetë, pa shtrëngime fizike dhe presione psikologjike. Në kushtet aktuale që ndodhen zyrat e punës të punonjësve të policisë, intervistimi i tyre mund të shkaktojë traumatizim plotësues të të miturit.

Ndihma juridike dhe psikologjike

Grupi i inspektimit konstatoi se në momentin e inspektimit, në dhomat e shoqërimit nuk kishte asnjë person të shoqëruar. Në mungesë të tyre, u intervistuan punonjësit e policisë që kryejnë veprime procedurale me personat e shoqëruar, ku rezultoi se, në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit madhorë nuk kishin mundësi financiare për të pajtuar avokat privat dhe kërkonin ndihmë juridike, atyre iu sigurohej asistencë ligjore apo mbrojtja me avokat kryesisht.

Përgjatë inspektimit në Stacionin e Policisë Fushë-Krujë, u konstatua se kishte një listë të afishuar në ambientet e shoqërimit ku mund të evidentoheshin avokatët kryesisht.

Përgjatë inspektimit punonjësit e policisë i parashtruan grupit të inspektimit, se në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit ishin të mitur, veprimet procedurale kryheshin në praninë e detyrueshme të avokatit mbrojtës të caktuar kryesisht dhe të psikologut.

Përgjatë inspektimit dhe bisedës me oficerët e policisë gjyqësore konstatuam se prania e psikologut sigurohej nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë.

Në rastet kur të shoqëruarit paraqesin probleme shëndetësore, punonjësit e policisë lajmëronin urgjencën dhe i shoqëronin ata në Spitalin e Qytetit të Krujës.

Ndërkohë u konstatua se në këtë Stacion Policie zbatohet detyrimi ligjor, për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimin e çështjes përkatëse.

⁸ Kreu VII. Pika 2.1/k e procedurës standarde thuhet se: “I mituri në konflikt me ligjin gëzon të drejtat e parashikuara në Kodin e Procedurës Penale si dhe të drejtat e posaçme të parashikuara në Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur”. I mituri duhet të mbahet në dhoma/ambiente të ndarë nga personat madhorë dhe të ndarë nga të miturit e tjerë sipas gjinisë”.

Grupi i inspektimit të Avokatit të Popullit këqyri disa praktika të njëpasnjëshme ku në përfundim të procedurave dhe veprimeve të kryera nga punonjësit e policisë, u konstatua se disa nga “Procesverbalet e Shoqërimit”, ishin të plotësuar korrekt në rubrikat e tij.

Për sa më sipër dhe me qëllim zgjidhjen e problemeve të konstatuara gjatë këtij inspektimi, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”* dhe në bazë të nenit 21/b të ligjit nr. 8454 dt.04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, i ndryshuar, ku përcaktohet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”*,

REKOMANDOJMË:

1. Marrjen e masave për krijimin në ambientin e shoqërimit në Stacionin e Policisë Fushë-Krujë të një dhome për marrjen në pyetje të të shoqëruarve (të arrestuar në flagrancë), para se të kalojnë në dhomat e sigurisë, si dhe instalimin e sistemit të monitorimit me video dhe audio në dhomën e marrjes në pyetje/intervistimin e personave të shoqëruar nga oficerët e policisë gjyqësore, për personat që do të akomodohen në ambientet e sigurisë të Bllokut të Sigurisë në Tiranë.
2. Marrjen e masave nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit për krijimin e një ambienti të veçantë për intervistimin e të miturve në konflikt me ligjin, duke ofruar një ambient të përshtatshëm, që duhet të jetë i rregulluar në mënyrë të posaçme për zhvillimin e bisedave me fëmijët.
3. Marrjen e masave për vendosjen e dyerve në dhomat e shoqërimit të Stacionit të Policisë Fushë-Krujë sipas parashikimeve në Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 894, datë 19.07.2022, për miratimin e procedurës standarde *“Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”*.
4. Marrjen e masave për sigurimin e sistemit të ngrohje/ftohjes në dhomat e shoqërimit të Stacionit të Policisë Fushë-Krujë kryesisht për ngrohjen e ambienteve në periudhën e dimrit.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.

KOMISIONERI
i Mekanizmit Kombëtar
për Parandalimin e Torturës
(MKPT)
Ahmet PRENÇI
d.v